



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT  
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

Nr. 2156 Prot.



REPUBLIKA E KOSOVËS

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT

Nr. 1794 Prot

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, (ILDKP) i cili është Autoriteti kompetent për qëllimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, (referuar si palë)

dhe

Agjencia kundër Korrupsionit, (AKK) e cila është Autoriteti kompetent për qëllimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, (referuar si palë)

**BIEN DAKORT**

për nënshkrimin e kësaj Marrëveshje me qëllim forcimin e bashkëpunimit në përmirësimin e veprimtarisë institucionale në kuadër të luftës kundër korrupsionit; ndarjes së praktikave më të mira në zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave dhe të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të nëpunësve publikë; si dhe bashkëpunimin konkret ndërinstitucional në kryerjen e hetimeve të përbashkëta;

## **BAZUAR NË**

rëndësinë e bashkëpunimit dhe harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të rajonit në përputhje me standartet ndërkombëtare;

## **DUKE MARRË NË KONSIDERATË**

faktin që parandalimi i korrupsionit është po aq i rëndësishëm sa identifikimi, investigimi dhe procedimi i aferave korruptive; që bashkëpunimi rajonal në secilin prej këtyre aspekteve nxit përpjekjet e palëve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik;

## **DUKE PASUR PARASYSH**

përpjekjet dhe eksperiencat e secilës palë, përfituese; promovimin dhe integritetin e mirëqeverisjes; forcimin e shtetit ligjor dhe mbrojtjen e interesave të shtetit;

**Palët bien dakort mbi Marrëveshjen e Bashkëpunimit, si më poshtë:**

### **NENI 1**

#### **Qëllimi**

Palët të jenë pjesë e një bashkëpunimi me qëllim shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave më të mira, përmes:

- 1.1. Hartimit të strategjive dhe politikave rajonale në parandalimin e korrupsionit në fushat e veprimtarisë institucionale respektive;
- 1.2. Shkëmbimit të eksperiencës në procedurat e deklarimit të interesave private dhe parandalimit e trajtimit të rasteve të konfliktit të interesave;
- 1.3. Mundësimin të trajnimeve profesionale të stafit;
- 1.4. Përfshirje në aktivitetet kombëtare në kuadër të luftës kundër korrupsionit;
- 1.5. Ndërmjetësim në planin e bashkëpunimit rajonal dhe më gjerë.

### **NENI 2**

#### **Fusha e zbatimit**

Me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, palët angazhohen si më poshtë:

- 2.1. Realizimin e projekteve të përbashkëta me qëllim trajnimin e funksionarëve dhe të nëpunësve publikë;

2.2. Organizimin e seminareve, workshop-eve, vizitave studimore, konferencave në shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira të punës;

2.3. Mundësimin e asistencës për njëri – tjetrin me qëllim harmonizimin e legjislacionit vendas në përputhje me standartet Europiane.

### **NENI 3**

#### **Format e tjera të bashkëpunimit**

Në funksion të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, Palët angazhohen në forma të tjera bashkëpunimi, përmes:

3.1. Këshillimeve, shkëmbimit të të dhënave që ato disponojnë, informacionit teknik dhe dokumentimit të informacionit përmes kanaleve të komunikimit zyrtar;

3.2. Realizimeve të kërkimeve të përbashkëta në çështje me interes të përbashkët.

### **NENI 4**

#### **Komunikimi**

Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes dhe për përmbushjen e detyrimeve të tjera të përcaktuara në këtë dokument.

### **NENI 5**

#### **Shpenzimet e bashkëpunimit**

Palët angazhohen personalisht të përballojnë shpenzimet për zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.

### **NENI 6**

#### **Ndryshimi i Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin e të dy palëve.

**NENI 7**  
**Hyrja në fuqi**

Marrëveshja e Bashkëpunimit hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dyja Palët përfituese.

Kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim dërguar palës tjetër.

Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe dy të tjera në Agjencionin Kosovar kundër Korrupsionit.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet sot në Tiranë, datë 18 Maj 2012.

**PËR INSPEKTORATIN E LARTË TË  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT  
TË PASURIVE**

**PËR AGJENCINË KUNDËR  
KORRUPSIONIT**

**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM**

**ADRIATIK LLALLA**



**DREJTOR**

**HASAN PRETENI**

